

D E K R E T
Nr.1187, datë 8.8.1995

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7631, DATË 29.10.1992 "PËR FALIMENTIMIN E
NDËRMARRJEVE SHETËRORË"**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr.7631, datë 29.10.1992 "Për falimentimin e ndërmarrjeve shetërore", pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

"Dispozitave të këtij ligji nuk i nënshtrohen ndërmarrjet, të cilat deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij dekreti, janë në varësi të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve. Falimentimi dhe likuidimi i tyre bëhet në rrugë administrative dhe sipas kriterëve e procedurave të miratuara nga Këshilli i Ministrave".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 16 gusht 1995.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI
Sali Berisha